

1 E enjte, 14 prill 2022

2 [Konferencë për ecurinë e gjendjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari u paraqit përmes videolidhjes]

5 --- Fillon në orën 09.30

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëmëngjes dhe mirë se
7 vini, këtu brenda dhe jashtë sallës së gjyqit.

8 Znj. Sekretare nga paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
10 Gjykatës, kjo është çështja KSC-BC-2020-04, Prokurori i
11 Specializuar kundër Pjetër Shalës.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj.
13 Sekretare.

14 Tani do t'u kërkoja palëve dhe pjesëmarrësve që të
15 paraqesin veten.

16 Fillojmë me ZPS-në. Z. Prokuror ju e keni fjalën.

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar
18 Gjykatës. Sot këtu është Bernhard Kuschnik, Zyrtar juridik i
19 Prokurorisë; Valeria Bolici, Prokurorore; Margaux Portier,
20 Zyrtar ligjor i asociuar, Moira van de Poel, stazhiere; dhe
21 Filippo de Minicis, Prokuror i asociuar.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit Prokuror.

23 Dhe tani e ka Mbrojtësja e Viktimave, Mbrojtësi i
24 Viktimave

25 Z. Laws, më duket se mikrofonit nuk punon, ka një problem

1 me zërin. Nuk ju dëgjojmë dot ende. E shoh që është mikrofoni
2 i mbyllur. Tani mikrofoni në ekran nuk është - duket që është
3 i hapur por unë përsëri nuk të dëgjoj. Të shohim me
4 departamentin audiovizuar. Znj. Sekretare a mund të
5 verifikojmë nëse mund të rregullojmë lidhjen zanore.

6 Z. Laws, a më dëgjoni? Pra, kemi një problem me lidhjen.
7 Teknikët do të përpiqen ta zgjidhen në minutat në vazhdim. Më
8 tregoni nëse mund t'ju paraqes unë. Jeni z. Laws, Mbrojtësi i
9 Viktimave dhe këtu jeni për të përfaqësuar viktimat. E shoh që
10 ju po pohoni duke miratuar këtë. Faleminderit z. Laws. Do të
11 bëjmë të pamundurën me qëllim që t'u mundësojmë të merrni
12 fjalën në minutat në vazhdim.

13 Por e shoh aktualisht që jeni lidhur me audion, që e
14 dëgjoni këtë seancë që është edhe gjëja më e rëndësishme tani.

15 Tani i kthehem palës Mbrojtëse.

16 Z. Gilissen.

17 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryetar. Unë jam
18 z. Gilissen, që jam këtu së bashku me z. Aouini,
19 bashkëavokatin tim; dhe z. Shala është me ne i lidhur me
20 video.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Gilissen.

22 Z. Shala ka rënë dakord që të mos jetë i pranishëm në
23 sallën e gjyqit sot dhe na ndjek me videolidhje.

24 Tani i kthehem Administratës.

25 Z. NILSSON: [Përkthim] Faleminderit. Jam Jonas Nilsson, i

1 Departamentit të Shërbimeve Juridike.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Dhe për sa i përket
3 procesverbalit jam Nicolas Guillou, që është Gjykatësi i
4 Procedurës Paraprake.

5 Më 31 maj unë caktova këtë konferencë të shtatë të
6 synimit - për ecurinë e çështjes dhe synimi është që të
7 diskutojmë pikë -- që të diskutojmë pikërisht të gjitha
8 çështjet e nxjerrës së materialeve, materialeve provë,
9 përkthimeve, ecurinë e hetimeve të ZPS-së, të Mbrojtjes,
10 pikat e dakordësimit në lidhje me çështjet juridike dhe
11 faktike dhe pastaj çështje që mund të ngrini.

12 Falënderoj të gjitha palët për parashtrimet që kanë bërë.
13 Si zakonisht do tu kërkoj palëve që t'i paraqesin pikëpamjet e
14 tyre në mënyre koncize, pra, të shkurtër dhe do t'i diskutojmë
15 të gjitha një nga një.

16 Por përpara se të hymë në këtë pikë dua një çështje një
17 paraprake.

18 Në materialin F00171, pala Mbrojtëse ka thënë se pas
19 vendimit të Gjykatës së Apelit të 11 shkurtit 2022 i ka
20 kërkuar qeverisë së Belgjikës për të treguar nëse është
21 gatshme dhe ka kapacitet për të zbatuar kushtet e lirimit të
22 përkohshëm që ka -- i kishte propozuar përmes Zyrës së
23 Koordinimit të Mbrojtjes dhe Zyrës Administrative.

24 Pala Mbrojtëse ka thënë se nuk ka marrë njoftim të
25 menjëhershëm na Zyra e Administratës lidhur me përgjigjen që

1 ka dhënë Ministria e Drejtësisë Federale të Belgjikës me 30
2 mars 2022.

3 Megjithatë pala Mbrojtëse nuk e ka bashkëngjitur këtë
4 korrespondencë e lartpërmendur me -- bashkë me parashtrimet e
5 saj në rishikimin e parandalimit të z. Shala. Unë synoj që ta
6 urdhëroj Mbrojtjen dhe Zyrën Administrative që këtë
7 korrespondencë ta dorëzojnë përpara seancës së ardhme të
8 rishikimit të paraburgimit.

9 Dhe do t'i kërkoj palëve nëse kanë ndonjë gjë për të
10 thënë në këtë kontekst.

11 Z. Gilissen.

12 Z. GILISSEN: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë z. President,
13 është faji im. Po bëjmë përpjekje të përsheptuara për ta bërë
14 një gjë të tillë. Ju kërkoj ndjesë.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] S'ka nevojë që të kërkon
16 ndjesë z. Gilissen. Kjo mund të zgjidhet shumë lehtë.

17 Z. Nilsson, a keni ndonjë parashtrim për të bërë?

18 Z. NILSSON: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës, nuk kam
19 gjë për të thënë.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Prokuror?

21 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo nuk ka asgjë që kam për të
22 thënë.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] I kam dëgjuar palët. Tani
24 urdhëroj, jap urdhrin e parë gojor.

25 I kërkoj, i urdhëroj Mbrojtjes që në koordinim me Zyrën

1 Administrative të dorëzojnë korrespondencën që kanë patur me
2 autoritetet belge, lidhur me gatishmërinë dhe kapacitetin e
3 tyre për të zbatuar kushtet e lirimit të përkohshëm të z.
4 Shala dhe nëse është e mundur, që kjo korrespondencë të
5 dorëzohet jo më vonë se e marta, 19 prill 2022.

6 Në rast rastin e -- kur korrespondenca e lartpërmendur
7 dhe korrespondenca tjetër i është dërguar Zyrës
8 Administrative, e urdhëroj Zyrën Administratave që këtë
9 korrespondencë ta dorëzojë në të njëjtën ditë.

10 Dhe duke patur parasysh informacionin që shqyrtohen, të
11 gjitha këto parashtime po të jetë e domosdoshme do të jenë
12 konfidenciale.

13 Dhe urdhëroj, për më tepër, Zyrën Administrative,
14 Mbrojtjen dhe ZPS-në sipas rastit, që materialet publike të
15 redaktuara lidhur me këto parashtime të dorëzohen jo më vonë
16 se 22 prill 2022 dhe kjo është për dosje të 00152, 171 dhe 177
17 dhe së fundmi 184.

18 Dhe këtu përfundon edhe urdhri im i parë gojor.

19 Të kalojmë tani në temën e parë që është edhe nxjerrja e
20 materialeve.

21 Së pari, do t'ja jap fjalën të gjitha palëve për të folur
22 mbi të gjitha këto çështje në mënyrë të veçantë. Së pari,
23 lidhur me materialet e rregullës 102(1)(b) që është materiali
24 që ZPS-ja kërkon të paraqesë gjatë gjyqit; më pas materialet e
25 rregullës 102(3) që është materiali i lidhur me çështjen dhe

1 pjesë e listës së ZPS-së; dhe pastaj materialet e 103-ish që
2 janë materialet shfajësuese; dhe më pas materialin e rregullës
3 107 që është material për të cilin kërkohet miratimi i palës
4 dhënëse.

5 Tani të kaloj tek materiali që synon të paraqesë në gjyq
6 ZPS-ja.

7 Në parashtrimet e saj me shkrim ZPS-ja ka thënë që kishte
8 përfunduar nxjerrjen e materialeve të rregullës 102(1)(b) me
9 përjashtim të disa artikujve të cilët janë mbajtur për shkak
10 të autorizimit juridik dhe të cilët do të nxirren kur të
11 përfundojnë masat mbrojtëse.

12 ZPS-ja ka thënë që do të nxjerrë disa përkthime të
13 materialeve që janë në këtë kategori pas kërkesës që ka bërë
14 Mbrojtja për një gjë të tillë. Variantet me më pak redaktime
15 të disa deklaratave dhe transkriptet dhe përkthimet e
16 redaktuara të përkthimeve të varianteve anglisht të
17 intervistës së të akuzuarit për ZPS-në.

18 ZPS-ja ka thënë që këto nxjerrje nuk janë prova të reja,
19 kështu që do të përfundojnë - e konsideron të mbyllur këtë
20 çështje. ZPS-ja kërkon që të shtojë materiale të tjera.

21 ZPS-ja po kështu ka kërkuar -- ka kërkuar leje për të
22 nxjerrë materialet e 102(2). Pala Mbrojtëse e ka kundërshtuar
23 një gjë të tillë në këtë fazë të vonshme të proceduarave.

24 ZPS-ja po kështu ka thënë se për shkak të hetimeve të
25 përfunduara kohët e fundit, ka nevojë që të paraqesë në bazë

1 të rregullës 102(2) deklaratat e një dëshmitari shtesë. Dhe në
2 këtë fazë sipas ZPS-së këto materiale nuk mund të nxirren për
3 shkak se kërkohet që fillimisht të bëhet ndryshimi i masave
4 mbrojtëse dhe kjo kërkohet nga një palë e tretë. Me t'u
5 siguruar ky ndryshim, ZPS-ja ka thënë se do të jetë në gjendje
6 që ta bëjë kërkesën në bazë të rregullës 102(2).

7 Nuk do të jap vendim lidhur me këtë kërkesë të rregullës
8 102(2) me gojë sot, pasi dua që të nxjerr një vendim të
9 konsoliduar së bashku me kërkesën e ZPS-së.

10 Dhe për këtë arsye i kërkoj ZPS-së të më thonë se kur
11 dëshiron ta paraqesë këtë kërkesë, duke shpresuar që kjo do të
12 ndodhë në ditët në vazhdim.

13 Unë nuk dua që të pranoj kërkesa të tilla pas fundit të
14 prillit. ZPS-ja nuk mund ta ndryshojë çështjen e saj gjatë të
15 gjithë kohës.

16 Unë i kërkoj ZPS-së, po kështu, që të konfirmojë që nuk
17 do të ketë materiale të tjerat të rregullës 102(1)(b) të cilat
18 do të nxirren dhe do të tregojë një afat kohor për mbushjen e
19 rubrikave në *Legal Workflow*; dhe të tregojë nëse do ta
20 përfundojë këtë përpara fillimit të gjyqit.

21 Dhe së fundmi i kërkoj palës Mbrojtëse që të bëjë
22 parashtrimet të saj lidhur me përfundimin e rubrikave të
23 dëshmitarëve në *Legal Workflow* dhe si ndikon kjo në aftësinë
24 për ta përgatitur këtë gjyq

25 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar

1 Gjykatës.

2 Përveç parashtrim me shkrim që i keni përmbledhur, ju i
3 nderuar Gjykatës, ne mund t'ju përditësojmë lidhur me ecurinë
4 e kërkesave të rregullës 102(2), të cilat nuk i përfundojmë
5 dot për shkak të arsyeve që ju i keni përmbledhur, i nderuar
6 Gjykatës.

7 Ne kemi ndërmarrë hapat e parë. Tani kemi siguruar
8 miratimin e palëve të interesuara dhe kemi filluar përgatitjen
9 e mocionit që ne besojmë se do ta dorëzojmë brenda javës së
10 ardhshme.

11 I nderuar Gjykatës, kjo do të varet nga koha që do të
12 kërkojë pala e tretë për të na kthyer përgjigje. Kjo pra do të
13 ndikojë në mundësinë tonë për të nxjerrë këto materiale - këto
14 deklarata shtesë, siç e kemi thënë edhe në mocionet - në
15 parashtrimet tona me shkrim.

16 Mund t'ju sigurojmë, i nderuar Gjykatës, që materiali
17 është i kufizuar edhe nga pikëpamja sasiore dhe cilësore ka të
18 bëjë me një dëshmitar. Dhe siç e kemi shpjeguar në mocionet,
19 në parashtrimet tona me shkrim është e kufizuar nga
20 fushëpërfshirja, kështu që nuk parashikojmë që do të ketë
21 nevojë ndonjë vonesë që mund të shqetësojë -- që mund t'ju
22 shqetësojë ju, i nderuar Gjykatës, apo palës Mbrojtëse.

23 Për sa i përket rubrikave të dëshmitarëve, ne i nderuar
24 Gjykatës, kemi plotësuar dhjetë nga pesëmbëdhjetë entitete të
25 tilla.

1 Po ta - në qoftë se ju, i nderuar Gjykatës, do ta
2 miratoni mocionin tonë të rregullës 102(2), të cilin e kemi
3 dorëzuar, atëherë do të ishim në gjendje që të plotësonim edhe
4 rubrikat e tjera të dëshmitarëve, por sigurisht mund t'ju
5 sigurojmë që këtë do ta përfundojmë përpara fillimit të
6 gjyqit. Unë besoj që i kam dhënë përgjigje kërkesave që ju
7 keni ngritur në këtë moment, i nderuar Gjykatës.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] A mund të konfirmoni që nuk
9 do të ketë materiale të rregullës 102(1)(b) të cilat mbeten
10 për t'u nxjerrë

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës, siç e
12 kam thënë në parashtrimet tona me shkrim ne po përpigemi të
13 nxjerrim disa përkthime, gjashtë të tilla të materialeve të
14 rregullës 101(2)(b). Janë katër përkthime dhe dy transkriptime
15 që i ka kërkuar pala mbrojtëse. Ne do i nxjerrim këto por nuk
16 ka materiale të tjera që ne i dimë të cilat duhen nxjerrë në
17 bazë të rregullës 102(1)(b), i nderuar Gjykatës.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

19 Z. Gilissen.

20 Z. Aouini.

21 Z. AOUBINI: [Përkthim] Mirëmëngjes të nderuar Gjykatës,
22 faleminderit.

23 Përpara se të trajtojmë këtë çështje a mund të paraqes
24 një çështje, një koment paraprak në lidhje me urdhrin gojor që
25 lëshuat? Ne mund ta bëjmë këtë më vonë por besoj se do të

1 ishte më mirë ta bëjmë këtë përpara se z. Gilissen të mund të
2 bëjë komentet e tij në lidhje me rregull 101(2)(b).

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Vazhdoni.

4 Z. AOUBINI: [Përkthim] Thjeshtë për të thënë që dita e
5 nesërme dhe e hënë nuk janë ditë pune dhe ne jemi të zënë për
6 të përgatitur mocionin tonë përfundimtar, i cili do të
7 dorëzohet gjatë ditës së sotme, vonë gjatë ditës së sotme.
8 Javën e ardhme do të kemi mundësinë që të përballohem me
9 afatin për certifikimin e apelit lidhur me datën 20.

10 Dhe ne do të kërkonim leje që ju, i nderuar Gjykatës, të
11 mund të ndryshoni afatet e paraqitura në faqen 4, rreshti 17,
12 deri në faqen 5 rreshti 11 deri nga fundi i asaj jave, pra
13 data 22 prill me qëllim që ne të mund t'i ndryshojmë -- të
14 mund t'i përballojmë këto parashtrim, i nderuar.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Aouini kërkesa juaj ka
16 të bëjë me urdhrin e fundit të urdhrit tim të fundit gojor që
17 ka të bëjë me versionet publike të redaktuara të mocioneve dhe
18 jo me korrespondencën që ka të bëjë me Mbretërinë e Belgjikës?

19 Z. AOUBINI: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Ne jemi të
20 - jemi të bindur që do të mund ta përfundojmë këtë shtojcë.
21 Pra mund ta bëjmë këtë me datën 19 dhe më pas do të merremi me
22 çështjen e varianteve të redaktuara publike, pra bëhet fjalë
23 për variantet publike të redaktuara. Me qëllim që t'i bëjmë me
24 mënyrën e duhur.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Kur mendoni se mund t'i

1 dorëzoni këto versione të redaktuara publike?

2 Z. AOUINI: [Përkthim] Nga fundi i javës, i nderuar
3 Gjykatës, data 22. Pra dy, -- kërkojmë dy ditë shtesë në
4 mënyrë që të mund t'i përfundojmë dhe t'i - këto parashtrime.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Aouini, do
6 ta trajtoj këtë çështje pak më vonë gjatë kësaj seance. Dhe ka
7 gjasa që ta ndryshoj urdhrin tim gojor.

8 Tani mund të kalojmë në materialet e 102(2) dhe kërkesat
9 e bëra.

10 Z. AOUINI: [Përkthim] Z. Gilissen do të trajtojë këtë
11 çështje.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Aouini.

13 Z. Gilissen.

14 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit i nderuar Gjykatës.
15 Për sa i përket nxjerrjes së materiale (a), ne mbajmë shënim
16 atë që na ka thënë Prokuroria. Nuk kam gjë tjetër për të
17 shtuar. Vetëm një gjë.

18 Kemi një kërkesë për të shtuar katër dëshmitarë, si pjesë
19 të provave. Kolegu im e kupton shumë mirë këtë çështje. Kjo
20 është e vetmja gjë që doja të thoja, pra.

21 Ne kemi kërkuar 580 materiale nga ZPS-ja të cilat janë në
22 bazë të rregullës 102(3).

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Me këtë çështje do ta
24 trajtojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, z. Gilissen. Ju
25 lutem që të përqendrohemi në rregullin 102(1)(b) dhe 102(2).

1 Z. GILISSEN: [Përkthim] Dakord. Kaq kisha për të thënë.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Gilissen.

3 Prokurori, doni të shtoni ndonjë gjë

4 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Si zakonisht unë do ta
6 vlerësoj në qoftë se ju kërkesat do t'i paraqisni sa më shpejt
7 që të jetë e mundur. E dimë që jeni të kufizuar nga miratimi i
8 palës së tretë, por në qoftë se nuk jeni në gjendje që t'i
9 dorëzoni në dy javët në vazhdim do ta vlerësoja në qoftë se do
10 të më informoni pasi nuk do të pres për këtë për të nxjerrë
11 vendimin lidhur me kërkesën tuaj të 102(2).

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit - do ta bëjmë këtë
13 i nderuar Gjykatës. Do t'ju informojmë

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

15 Tani të kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës që
16 është nxjerra e materialeve provë, që janë materialet e
17 rregullës 102(3).

18 Pala Mbrojtëse ka bërë një kërkesë *inter partes* me listën
19 e 580 dokumenteve të nxjerra nga lista e ZPS-së e rregullës
20 102(3) e përditësuar dhe me disa shpjegime të rishikuara
21 pjesërisht.

22 ZPS-ja në qoftë se nuk e kam gabim e ka nxjerrë pjesën e
23 parë të materialeve të kërkuara nga Mbrojtja mbrëmë, dje
24 pasdite. Më gjithë këtë, ZPS-ja ka thënë që mbetet një numër i
25 madh dokumentesh të cilat nuk janë rishikuar ende dhe nuk janë

1 nxjerrë.

2 Pala Mbrojtëse ka kërkuar disa materiale të cilat nuk
3 kanë përshkrime të rishikuara dhe që nuk janë kërkuar më parë
4 dhe se mbetet një -- dhe si një numër i dokumenteve që kërkon
5 -- Mbrojtja do të kërkojë që ZPS-ja të kërkojë masa mbrojtëse.

6 I kërkoj ZPS-së që të tregojë një afat për masat
7 mbrojtëse dhe ta bëj këtë përpara 6 majit.

8 I kërkoj ZPS-së po kështu që të konfirmojë që nuk do të
9 kundërshtojë rëndësinë materiale të dokumenteve që kërkon
10 Mbrojtja.

11 Me gjithë këtë, përpara se t'i jap fjalën ZPS-së për këtë
12 çështje vërej se përveç nxjerrjes së materialeve që janë pjesë
13 e njoftimit të rregullës 102(3), ZPS-ja kërkon që të shtojë
14 edhe materiale të reja në këtë listë.

15 Në parashtrim F00170 të paraqitur më 25 mars 2022, ZPS-ja
16 kërkon leje për të amenduar njoftimin e paraqitur sipas
17 rregullës 102(3) të Rregullores me tre kategori dokumentesh.
18 Kategoria e parë ka të bëjë me 13 dokumente për të cilat është
19 zgjidhur statusi i rregullës 107 dhe është zgjidhur në këtë
20 mënyrë që të mundësojë zgjedhjen e tyre. Kategoria e dytë ka
21 të bëjë me vendimin me konfirmimin e aktakuzës dhe
22 pranueshmërinë e provave të një çështje tjetër e datës 24
23 nëntor 2010 dhe procesverbalin e seancës së konfirmimit të
24 aktakuzës, në të njëjtën çështje të datës 22 tetor 2010.
25 Kategoria e tretë ka të bëjë me fotografitë e disa

1 dëshmitarëve të cilat i ka kërkuar pala mbrojtëse.

2 Në parashtimin F00176 të paraqitur me 6 prill 2022, pala
3 Mbrojtëse është përgjigjur se nuk e kundërshton kërkesën e
4 ZPS-së por thekson se ka nevojë për kohë të mjaftueshme për të
5 analizuar dhe rishikuar dhe analizuar dokumentet shtesë si dhe
6 të tërë tërësinë e materialeve të nxjerra nga ZPS-ja.

7 E nënvizoj që dokumentet e kategorisë së dytë janë të
8 vitit 2010, pra para 12 vitesh. I kërkoj ZPS-së që të
9 shpjegojë se përse nuk janë përfshirë ato në njoftimin e ZPS-
10 së sipas rregullës 102(3) përpara.

11 Dhe në fund vërej që në parashtim me shkrim që ZPS-ja ka
12 thënë se synon të bëjë një kërkesë gojore gjatë kësaj seance
13 për të ndryshuar përsëri listën e rregullës 102(3) duke shtuar
14 një dokument tjetër.

15 I kërkoj ZPS-së ta paraqesë kërkesën tani dhe për të
16 justifikuar se përse ende po diskutojmë ende listën e
17 rregullit 102(3) në këtë fazë të vonëshme të procedurave
18 gjyqësore.

19 I kërkoj alës Mbrojtëse po kështu që ta japë përgjigjen
20 ndaj kërkesës së ZPS-së me gojë, pasi unë synoj që të nxjerr
21 një urdhër gojor për amendimin e listës së ZPS-së, sipas
22 rregullës 102(3) nga fundi i kësaj seancë.

23 Pala Mbrojtëse për më tepër ka thënë se nuk është në
24 gjendje që të ketë një qëndrim për sa i përket synimit për të
25 kundërshtuar pranueshmërinë e materialeve provë, të cilat nuk

1 janë nxjerrë në bazë të rregullës 102 -- të janë nxjerrë sipas
2 102 të Rregullores dhe shpresojmë që ta përfundojë këtë pasi
3 të jenë nxjerrë të gjitha materialet e Prokurorisë.

4 I kërkoj palës Mbrojtëse që të specifikojë nëse ka
5 kundërshtuar ndonjë material që ka deri më tani dhe nëse është
6 në gjendje që të japë ndonjë -- të tregojë se kur mendon që
7 këto kundërshtime t'i dorëzojë nëse ka ndërmend ta bëjë këtë.

8 Z. Prokuror, juve e keni fjalën.

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
10 Gjykatës.

11 Për sa i përket pyetjes së parë, ne do ta paraqesim
12 mocionin mbi masat mbrojtëse brenda datës 6 maj, siç kërkuat
13 ju, i nderuar Gjykatës.

14 Për sa i përket rëndësisë materiale të materialeve që
15 kërkon Mbrojtja, i nderuar Gjykatës, ne duam të përfundojmë
16 analizën tonë paraprakisht. Ne nuk e kemi përfunduar këtë dhe
17 nuk jemi në gjendje të tregojmë nëse do të kundërshtojmë
18 rëndësinë materiale të këtyre dokumenteve.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë z.
20 Prokuror. A do ta kundërshtoni rëndësinë materiale të
21 dokumenteve që kërkon Mbrojtja, a jeni në gjendje që ta bëni
22 këtë përpara datës 6 maj?

23 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës, do të
24 bëjmë të pamundurën që ta bëjmë këtë, në qoftë se vendosim që
25 të kundërshtojmë rëndësinë materiale të dokumenteve që kanë

1 kërkuar.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit

3 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Për sa i përket kërkesës për
4 amendimin e njoftimit të rregullës 102(3) dhe tre kategoritë e
5 identifikuar nga ju, i nderuar Gjykatës, do të përqendrohem
6 në kategorinë e dytë, në të cilën ju keni kërkuar informacion.

7 I nderuar Gjykatës, këto janë dokumente të cilat nuk kanë
8 vlerë prove. Ne e kuptojmë që duhet të ishin në listën
9 origjinale. Në fakt tërësia e dosjes është shumë e madhe. E
10 kemi rishikuar këtë edhe pas kërkesave që kemi marrë nga
11 Mbrojtja, për shembull, pas konferencës mbi ecurinë e çështjes
12 në janar, me qëllim që të kemi të tërë dosjen që të jemi në
13 gjendje që të orientohemi me [e pakuptueshme] materialet e saj
14 dhe këtë kemi bërë analiza të mëtejshme dhe prandaj kanë dalë
15 këto dokumente që kemi përfshirë tani.

16 Për sa i përket pjesës tjetër të kërkesës tuaj, i nderuar
17 Gjykatës, vërejmë që këtu bëhet fjalë për kategorinë e tretë
18 të materialit të kërkuar nga pala Mbrojtëse.

19 Këto janë, pra, kategoria e tretë që keni identifikuar ju
20 dhe prandaj i kemi përfshirë ato në këtë listë.

21 Për sa i përket kërkesës gojore që kemi thënë që do të
22 bëjmë, po e bëj këtë mocion tani për të shtuar materialin
23 TFHS00014574-00014576. Material i cili është zbuluar gjatë
24 analizimit të dokumentacionit të çështjes pasi kishte patur
25 një përsëritje të çështjeve, të materialeve të kësaj çështje

1 me - brenda disa dokumenteve. Ne e kemi përfunduar këtë
2 analizë tani edhe një herë e them, dosja ishte e gjerësishme
3 dhe jemi të bindur që të gjitha dokumentat ose janë nxjerrë
4 dhe mbetet vetëm ky dokument.

5 Dhe është një procesverbal me tre faqe, i nderuar
6 Gjykatës, ku i akuzuari ka ushtruar të drejtën për të mos
7 folur dhe prandaj po bëjmë këtë kërkesë për të amenduar listën
8 tonë, sigurisht në qoftë se këtë e kërkon edhe pala Mbrojtëse.

9 Dhe nëse pala Mbrojtëse dëshiron mund të kërkojë që t'ia
10 japim këtë dokument.

11 Dhe me këtë shpresoj që t'i kem dhënë përgjigje pyetjeve
12 që keni ngritur ju, i nderuar Gjykatës.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar z.
14 Prokuror.

15 Z. Gilissen.

16 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, z. Kryetar. Siç ju thashë pak
17 më herët, ne kemi kërkuar që të na jepnin 587 materiale, disa
18 na i kanë dhënë gjatë ditës së djeshme. Nuk i kemi marrë të
19 tëra dokumentet. Megjithëkëtë, nuk është problem që t'ju
20 komunikojmë këtë. Do ta bëjmë sa më shpejt që të jetë e
21 mundur. Kjo është pika e parë që desha të nënvizoje.

22 Pika (b) (ii) unë thjesht më duhet të mbaj shënim, i
23 nderuar Gjykatës.

24 Pikat e tjera më duket sikur ecin në rrugën e duhur. Unë
25 për sa i përket kësaj çështje mund të them që jemi -- ne jemi

1 dakord që me -- së bashku me ZPS-në t'i ndajmë të gjitha
2 materialet që kanë të bëjnë me çështjet që kanë të bëjnë me
3 përkthime që kanë mbetur, dokumentet e mbetura, e kështu me
4 radhë. Në qoftë se ka probleme që do të lindin, procedura do
5 të na mundojë që t'i zgjidhim këto së bashku me Panelin dhe ky
6 është një avantazh që na siguron ruajtjen e kohës.

7 Nuk e di nëse i kam -- jam dhënë përgjigje të gjitha
8 çështjeve që ngritët ju. Ju folët për pranueshmërinë e
9 provave. Janë gati ta shpjegoj nëse dëshironi.

10 Mund të them se tani jemi në gjendje të deklarojmë se do
11 ta kundërshtojmë provueshmërinë e disa materialeve që tashmë
12 janë nxjerrë në bazë të rregullës 102 të Rregullores.
13 Ndërgjegjshmëria profesionale më obligon që të theksoj se
14 Mbrojtja nuk është absolutisht në gjendje të bëjë deri para
15 datës 22 prill 2022.

16 Duhet të përcaktojmë të gjitha dokumentet për të cilat do
17 të ngremë kundërshtim në lidhje me pranueshmërinë. Kjo është
18 një punë mjaft e madhe dhe po punojmë në lidhje me dokumentet
19 që tashmë na janë dhënë. Këto dokumente që i përmenda për
20 mendimin tim janë shumë -- kërkojmë një detyrë mjaft delikate
21 dhe vëmendje të plotë.

22 E di që çështja në lidhje me z. Shala nuk është aq
23 voluminoze dhe nuk është më e rënda, në krahasim me të tjerat
24 me të cilat gjykata po merret dhe ky dallim mund të jetë edhe
25 thelbi i vështirësive që Dhoma ka hasur në disa raste.

1 Edhe pse akuzat kundër z. Shala janë mjaft të rënda,
2 pyetja që ngrihet është natyra e punës që duhet të bëhet. Ajo
3 është e njëjta sikur edhe me çështje të tjera. Do të thotë që
4 ne jemi të zënë me përpunimin e informacionit të shumtë që
5 është nxjerrë deri tani.

6 Nxjerrja e materialeve ka qenë një proces që nuk ka
7 shkuar pa vështirësi. Dua të shtoj që dijenia dhe studimi i
8 këtij informacioni nxjerr në pah disa surpriza apo befasi të
9 cilat lidhen pjesërisht edhe me problemin e pranueshmërisë.

10 Më konkretisht, ndonjëherë lajmet dhe media nxjerrin një
11 informacion, të themi shumë interesant, që i bën ato të bëhen
12 si të thuash temë e diskutimit për pranueshmërinë.

13 ... të komplotit kundër z. Dick Marty që është autor i
14 një raporti në lidhje me formimin e DHSK-së.

15 Ky komplot raportohet se është përgatitur nga zbulimi
16 serb, me synimin e fabrikimit dhe falsifikimit të disa të
17 ashtuquajturave "prova" dhe për këtë t'ia hedhin fajin
18 udhëheqësve kosovarë-shqiptarë.

19 Ky është një informacion. Por, kjo pasqyron në fakt disa
20 pyetje që mund të dalin edhe në çështjen e z. Shala.

21 Do të thotë, fabrikim apo falsifikim i mundshëm i
22 informacionit dhe materialeve, provave me synimin e implikimit
23 të disa individëve në kryerjen e disa krimeve. Ne kemi qenë në
24 terren, në Kosovë dhe kishim synimin që të kuptojmë disa gjëra
25 më mirë, t'i shohim disa gjëra më mirë, t'i dëgjojmë gjërat më

1 mirë. Unë nuk them se do të ketë ndonjë problem, por mund të
2 ndodhë që të ngrihet problemi i pranueshmërisë së disa
3 elementeve të disa provave.

4 Në këto kushte, të gjitha këto shpjegohen dhe
5 justifikojnë dhe se në këto rrethana dhe pa pasur nevojë që të
6 përsëriten apo të lexohen të gjitha dokumentet, ne nuk mund të
7 zotohemi për një datë të caktuar për përpunimin e
8 kundërshtimit në lidhje me pranueshmërinë e disa materialeve
9 që janë nxjerrë në bazë të rregullës 102.

10 Megjithatë, në qoftë se na kërkoni një deklaratë të
11 thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë në qoftë se synojmë të
12 kundërshtojmë pranueshmërinë e disa dokumenteve, nuk më duhet
13 më shumë kohë, mund thjesht t'ju them se do të kundërshtojmë
14 disa prova të nxjerra nga ZPS-ja, në bazë të rregullës 102 të
15 Rregullores. Megjithatë, në qoftë se ju kërkoni një shpjegim
16 më të hollësishëm për kundërshtimet tona në të ardhmen dhe për
17 secilin dokument veç e veç, pritni prej nesh që t'ju
18 drejtohem me parashtrime pasi të ketë përfunduar ZPS-ja me
19 detyrimet e veta të nxjerrjes.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Gilissen.

21 Nga ajo që kuptova, ju do të bëni - po bëni dy
22 parashtrime gojore? Nuk e kundërshtoni kërkesën e ZPS-së për
23 ndryshimin e njoftimit të vet dhe për shtimin e një prove në
24 atë njoftim. A është kështu?

25 Z. AOUBINI: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

1 Ne nuk do ta kundërshtojmë kërkesën, por e ruajmë të
2 drejtën që të përgjigjemi pasi ta kemi analizuar përmbajtjen e
3 dokumentit.

4 Ju i nderuar Gjykatës dhe kolegët nga ZPS-ja e dinë që
5 kemi bërë që në fillim një kërkesë të qartë se këto dokumente
6 bashkërisht si pjesë e dosjes së çështjes mund të na
7 dorëzohen, të na jepen në tërësi. Ajo që shkakton problem në
8 një prej takimeve midis palëve dhe është me shkrim në
9 paragrafin 10 të parashtrimeve të kolegëve tanë, ata në dukje
10 e kanë të qartë se është mjaftueshme që t'i përmendin
11 dokumentet e kësaj çështje sipas numrit të referencës. Një
12 prej këtyre dokumenteve ju e keni shumë të njohur, i nderuar
13 Gjykatës. S'ka nevojë që ta përmend. Kërkesa jonë në lidhje me
14 atë dokument nuk është vetëm që ai të shtohet në listën e
15 dokumenteve, por edhe të na dorëzohet.

16 Tani kolegu i Prokurorisë thotë se çdo dokument nga ajo
17 çështje gjyqësore ose është nxjerrë ose është përmendur në
18 listë. Ne duhet që të sigurohemi sepse përshkrimet dhe numrat
19 e referencës nuk mjaftojnë për ne që të identifikojmë që ky
20 dokument është pjesë e asaj dosjeje gjyqësore.

21 Prandaj, po e përsërisim edhe një herë për
22 procesverbalin, këto dokumente duhet të na dorëzohen të na
23 jepen dhe jo vetëm të na jepen në listë sepse prapë mund të
24 disi të na ikin.

25 Ne kemi kërkuar disa dokumente të cilat nuk kanë një

1 përshkrim të përditësuar dhe kjo u është shpjeguar edhe në
2 konferenca të tjera. Sikurse përpunojmë çështjen dhe mund t'i
3 bëjmë lidhjet midis numrave midis përshkrimeve dhe ndonjëherë
4 disa materiale janë të rëndësishme qartësisht për ne, përveç
5 atyre që na janë dhënë me përshkrimet e reja.

6 Prandaj, mendoj se e kemi të përlligjur kërkesën dhe këto
7 janë pikat e domosdoshme që deshëm t'i ngremë dhe si
8 veçanërisht ato dosjet e çështjeve që duhet të na dorëzohen
9 dhe jo vetëm të përmendën në listën.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Aouini.

11 Ju folët për dy kërkesat e ZPS-së dhe për një material
12 tjetër për të cilin tashmë kam marrë vendim. Për çështjen për
13 të cilën kam marrë vendim, ju mund të paraqitni një kërkesë
14 për leje për autorizim. Kjo çështje ka përfunduar se unë tani
15 kam nxjerrë një vendim për të.

16 A ju kam kuptuar drejtë? Si duhet? Se i referoheni asaj
17 çështje?

18 Z. AOUMINI: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, është puna për
19 një dokument që ka qenë objekt i asaj kërkesë. Ne nuk
20 kundërshtojmë që ZPS-ja të shtojë këtë dokument në njoftimin e
21 vet të përditësuar, por ngremë një çështje në lidhje me një
22 dokument që i takon një dosjeje të një çështjeje gjyqësore.

23 Ne duam që ZPS-ja atë dokumente që i shënon në listë, jo
24 vetëm t'i shënojë në listën e vet, në njoftimin e vet por edhe
25 të na i dorëzojë ato.

1 Ne nuk kemi kundërshtim, i nderuar Gjykatës, ne nuk
2 synimin që të kundërshtojmë vendimin thjesht duam që të mos
3 ketë keqkuptime dhe duam që ato që janë listë edhe të na
4 jepen.

5 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Së pari, të theksoj se
6 Mbrojtësi i Viktimave tani është përsëri i lidhur me
7 videolidhje.

8 Për sa i përket çështjes së vendosjes në listë të
9 materialeve të nxjerra, kuadri apo korniza procedurale vendos
10 një sistem sipas të cilit ne vendosim në qoftë se një dokument
11 do ta përdorim ose jo në paraqitjen e provave dhe prandaj atë
12 e nxjerrim sipas rregullës 102.

13 Sikurse thashë edhe më herët, mendoj se tani ose i kemi
14 nxjerrë ose i kemi futur në listë të gjitha dokumentet që i
15 kemi në zotërim për këtë dhe çështjet gjyqësore dhe për atë që
16 i përmend z. Aouini.

17 Nuk kam gjë tjetër për të shtuar.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit De Minicis.

19 Z. Aouini a keni diçka për të shtuar.

20 Z. AOUINI: [Përkthim] Shkurtimisht.

21 Kemi bërë përzgjedhjen nga njoftimi dhe kemi thënë se na
22 duhet çdo dokument nga ajo çështje - dosje e çështjes. Këtë e
23 themi që të tejkalojmë çdo vonesë të mundshme. Çdo gjë që
24 është pjesë e asaj dosjeje - çështjes me ato numra është
25 kërkuar, pra nga ai njoftim dhe nuk duam që të kemi devijime

1 nga procedura e zakonshme. Kjo është kërkesa jonë.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Aouini.

3 Tani do të kalojmë te materiali 103.

4 Në parashtrim e veta me shkrim ZPS-ja ka bërë të ditur se
5 -- nga konferenca e fundit ka nxjerrë dokumentet sipas
6 rregullës 103 në paketën e nxjerrë me numër 42. Sipas ZPS-së
7 me përjashtim të disa materialeve që janë objekt i kërkesave
8 për masa mbrojtëse të pazgjidhura, nuk ka dokumente të tjera
9 që kanë mbetur për t'u nxjerrë sipas kësaj rregulle. Ftoj ZPS-
10 në që të konfirmojë që të gjitha materialet e rregullës 103 i
11 janë nxjerrë Mbrojtjes

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës, mund të
13 konfirmoj se ato i janë nxjerrë Mbrojtjes.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

15 Z. Aouini ose Gilissen për materialin shfaqësues?

16 Z. AOUINI: [Përkthim] E konfirmojmë atë që tha Prokurori
17 dhe e çmojmë dorëzimin e këtyre materialeve.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

19 Atëherë e konsideroj se kjo kategori e materialeve ka --
20 nxjerrja e kësaj kategoria materialesh ka përfunduar.

21 Tani të kalojmë te rregulla 107 e materialit sipas kësaj
22 rregulle.

23 Më 6 prill të këtij viti, ZPS-ja ka bërë një kërkesë
24 sipas rregullës 107(2, ku informoi për autorizimin që ishte
25 refuzuar në lidhje me nxjerrjen e një numri dokumentesh të një

1 rëndësie më të vogël.

2 Sipas ZPS-së nuk ka dokumente të tjera sipas rregullës
3 107 për të cilat pritet marrja e autorizimit prej dhënësit të
4 informacionit.

5 I informoj palët që do të nxjerrë një vendim me shkrim në
6 lidhje me këtë dhe ftoj palët që të shprehen nëse duan të
7 shtojnë diçka tjetër

8 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo nuk kemi asnjë gjë për të
9 shtuar.

10 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo nuk kemi asnjë gjë për të
11 shtuar.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani të kalojmë te çështja
13 e përkthimit të parashtrimeve dhe provave materiale.

14 Në parashtrimet e veta ZPS-ja bën të ditur se ka
15 përfunduar përkthimet dhe transkriptimet e materialeve të
16 mbledhura gjatë hapave hetimore megjithatë, Mbrojtja bën të
17 ditur në parashtrimet e veta me shkrim se përkthimi i disa
18 dokumenteve nuk i është dhënë.

19 Dua të dëgjoj nga palët për ndonjë problem tjetër lidhur
20 me përkthimet. Gjithashtu ftoj palët që të qartësojnë në qoftë
21 se problemi që me të përballet Mbrojtja është ndonjë
22 mosmarrëveshje apo mosdakordim në lidhje me detyrimet e
23 përkthimit të palëve

24 Z. DE MINICIS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, siç thashë
25 edhe më herët kemi marrë edhe sot në mëngjes do të nxjerrim

1 gjashtë dokumente, përkthime dhe transkriptime, pra, të
2 dokumenteve që i ka kërkuar Mbrojtja.

3 Dje kemi marrë një email ku mbrojtja bën një përmbledhje
4 të çështjeve që ato i konsiderojnë si të ngutshme.

5 Ne falënderojmë Mbrojtjen për këtë dhe do të bëjmë çmos
6 që t'i dorëzojmë dokumentet e mbetura, përkthimet e mbetura sa
7 më shpejt që të jetë e mundur.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

9 Z. Gilissen.

10 Z. GILISSEN: [Përkthim] Siç e dini ju, i nderuar
11 Gjykatës, kemi në dispozicion tre burime për përkthimet: atë
12 të Zyrës Administrative, të Prokurorisë dhe burimet tona dhe e
13 kam me plot kënaqësi -- kam plot kënaqësi të deklaroj se nuk
14 kemi kurrfarë problemesh me përkthimet dhe dua të falënderoj
15 Zyrën Administrative dhe Prokurorinë për këtë.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Gilissen.

17 Z. Nilsson, a keni ndonjë çështje gjë tjetër për të
18 ngritur në lidhje me përkthimet e mbetura apo diçka të
19 ngjashme?

20 Z. NILSSON: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës, mund t'ju
21 konfirmoj se nuk ka kërkesa prioritare të pazgjidhura për
22 përkthim për sa i përket anës sonë.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

24 Atëherë të kalojmë te pika e ardhshme e agjendës, që janë
25 hetimet apo hapat hetimorë të mbetur të ZPS-së.

1 Në parashtrimet e veta ZPS-ja ka bërë të ditur se ka
2 kryer një numër të hapave hetimorë dhe ka kërkuar nxjerrjen e
3 disa materialeve të mbledhura gjatë këtyre hetimeve.

4 Ftoj ZPS-në që të na japë një përditësim dhe të na thonë
5 në qoftë se priten -- që nuk priten më hetime të tjera të ZPS-
6 së në këtë fazë.

7 z. Prokuror

8 Z. DE MINICIS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, mund
9 absolutisht t'ju konfirmoj që me një kusht se krejt çfarë kemi
10 për të themi në lidhje me këtë e kemi përfshirë në përthimet -
11 në parashtrimet me shkrim.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Sekretare a mund të
13 kalojmë në seancë të mbyllur përkohësisht?

14 [Seancë private]

15 [Seancë private teksti i fshirë]

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5 [Seancë e hapur]

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj.

8 Sekretare.

9 z. Aouini, a doni t'i përgjigjeni pikave të ngritura nga
10 ZPS-ja në parashtrimet e saj të fundit?

11 Z. AOUIINI: [Përkthim] Nuk kam për të ngritur asnjë pikë
12 tjetër. Ato që patëm për t'i bërë i bëmë. Të gjitha kërkesave
13 ju përgjigjemi me shkrim dhe do të vazhdojmë në atë mënyrë.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Aouini.

15 Pika e ardhshme e agjendës ka të bëjë me hetimet e
16 Mbrojtjes. Do t'i drejtohem së pari Mbrojtjes.

17 Nga parashtrimet e Mbrojtjes me shkrim e kuptoj se janë
18 në procesin e kryerjes së hetimeve, por për shkak të vonesave
19 në procesin e nxjerrjes së materialeve, Mbrojtja nuk mund të
20 tregojë për momentin kohëzgjatjen e hetimeve të saj të
21 pritshme.

22 Kërkoj gjithashtu nga Mbrojtja në qoftë se në këtë fazë
23 mund të konfirmojnë se a do të kërkojë kërkesa - bëjë kërkesa
24 në lidhje me mundësitë unike hetimore dhe në qoftë se do të
25 japë njoftim për alibi apo arsye të tjera që përjashtojnë

1 përgjegjësi penale.

2 Mbrojtja ka konfirmuar se synon që të dorëzojë dosjen e
3 vet paragjyqësore, por nuk mund të tregojë momentin kur.
4 Kërkoj nga mbrojtja që këtë informacion të na e japë sa më
5 shpejt që të jetë e mundur.

6 Megjithëse janë nxjerrë të gjitha dokumentet kryesore, si
7 dosja paraprake e ZPS-së, pastaj tabela sipas rregullës
8 109(c).

9 Unë prapëseprapë kam caktuar një afat kohor për
10 transmetimin e kësaj çështjeje për gjykim dhe kjo datë është
11 31 maj 2022.

12 Nuk e kam ndërmjet që t'i zgjas pa kufi afatet. Duhet që
13 palët të punojnë sa më shumë dhe sa më shpejt në mënyrë që
14 çështja t'i dorëzohet Trupit Gjykses për gjykim.

15 Në parashtrimet e veta me shkrim Mbrojtja nuk e bën të
16 qartë nëse kërkon një afat të ri për detyrimet e saj të
17 dorëzimit të dosjes paraprake edhe pse konkretisht ka bërë të
18 ditur se çdo kërkesë për shtyrjen e afatit të përkohshëm duhet
19 të jetë të ketë arsye bindëse.

20 Dua të nxjerr një urdhër gojor në fund të kësaj seancë në
21 mënyrë që të caktohet kalendari procedural i përditësuar dhe
22 data e dorëzimit të dosjeve e dosjes paraprake të mbrojtjes.

23 Nuk e kam ndërmend që ta ndryshoj kalendarin *proprio motu*
24 duhet palët vetë që të tregojnë zellin e duhur dhe të tregojnë
25 arsyet se pse ju duhet kohë më shumë. Pres nga Mbrojtja që të

1 tregojë nëse bën kërkesë për ndryshimin e afateve të
2 përcaktuara më herët dhe nëse po, të shpjegojë arsyet për
3 kohëzgjatjen e këtyre afateve dhe gjithashtu të tregojë se sa
4 kohë do t'i duhet për çdo hap të përshkruar përpara dorëzimit
5 të kësaj çështje të kalimit të çështjes për gjykim.

6 Koha që do t'i duhet për kërkesat sipas rregullës 102(3)
7 dhe koha për të përgatitur dosja paraprake në qoftë se do të
8 prapë. Pra, ftoj Mbrojtjen të na tregojë në qoftë se do t'i
9 duhet më shumë kohë për të përgatitur këtë parashtrime me gojë
10 në lidhje me kalendarin procedural.

11 Në qoftë se do t'i duhet kohë për përgatitjen e këtyre
12 parashtrim me gojë atëherë mund të bëjë një pauzë prej 15
13 minutash. Nëse nuk i duhet kohë atëherë ftoj menjëherë z.
14 Gilissen ose z. Aouini të bëjnë parashtrimet e tyre në lidhje
15 me kalendarin procedural.

16 Z. Gilissen, z. Aouini doni pushim apo doni t'i paraqisni
17 kërkesat tuaja gojore tani lidhur me kalendarin.

18 Z. GILISSEN: [Përkthim] Z. Kryetar dua të kem mundësinë
19 ta paraqes gojarisht qëndrimin tonë dhe pastaj më lejoni ca
20 kohë që këto parashtrim t'i bëj me shkrim. Në qoftë se jeni
21 dakord unë jam i gatshëm të jap disa komente paraprake lidhur
22 me këtë.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Gilissen më vjen keq që
24 të them që nuk jam dakord. Unë kam paraqitur kalendar
25 procedural në konferencën e fundit të ecurisë së çështjes dhe

1 ky kalendar ngelet aty. Duhet që palët të më paraqesin nevojë
2 shumë të madhe për të ndryshuar afatet kohore. Unë nuk do t'i
3 pezulloj në këtë mënyrë afatet kohore. Ekziston një kalendar
4 procedural. Unë i kuptoj të gjitha kufizimet që ka ZPS-ja
5 përfshirë edhe nxjerrjet e fundit nga ZPS-ja është fatkeqe që
6 ndodh një situatë e tij dy vite pas paraqitjes së aktakuzës,
7 një vit pas arrestimit të të akuzuarit, kështu që jemi në fund
8 të fazës së nxjerrjes së materialeve.

9 Nuk duhet të ishim këtu në këtë moment ku jemi. Por siç e
10 thashë më qartë do ta ndryshoj kalendarin procedural por nuk
11 do ta shtyj. Nëse keni nevojë për 20, 15, 30 minuta që të
12 paraqisni qëndrimin tuaj, do tua jap këtë afat kohor, por unë
13 shpresoj që ju të paraqisni se përse kërkonit që të shtyhen
14 këto afate. Dua që të më tregoni që kur do ta paraqisni dosjen
15 tuaj paraprake, sa kohë do t'ju duhet për hapat hetuese unike
16 dhe nëse dëshironi të paraqisni çështjen e alibisë apo jo.

17 I kam pyetur këto çështje shtatë herë që nga fillimi i
18 këtyre procedura dhe ka më shumë se një vit. Ne nuk jemi - ne
19 jemi të detyruar të që mos lejojmë vonesat të paarsyeshme dhe
20 po e bëj të qartë nuk jemi nuk do ta përfundojmë këtë seancë
21 të datës së sotëm duke pezulluar të gjitha afatet kohore dhe
22 duke e lënë të akuzuarin në errësirë për sa i përket
23 transferimit të çështjes së tij para Trupit Gjykses.

24 Pra, duhet të jem krejtësisht i qartë z. Gilissen, doni
25 do t'ju japim 15, 20 apo 30 minuta.

1 Z. GILISSEN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, dua të them
2 që mund të shpjegojmë jemi në gjendje të shpjegojmë lidhur me
3 aftësisë hetimore unike.

4 Nuk kemi nevojë për kohën nuk ka vështirësi për këtë
5 çështje. Është e njëjta gjë dhe prandaj preferoj që ta
6 shpjegoj gojarisht. Nuk është këtu që po i largohem
7 përgjegjësisë, nuk ka nevojë. Nuk është problem. Mund të them
8 këto çështje janë të përfunduara.

9 Për pjesën tjetër e pranoj mundësinë që më jepet për të
10 bërë parashtime me shkrim për t'ju përgjigjur të gjitha
11 pyetjeve dhe për të dhënë qëndrimin e palës Mbrojtëse.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Gilissen, faleminderit
13 për këtë çështje. I kemi vërejtur dhe për çështjen e mundësive
14 unike hetimore si dhe për alibinë apo arsyet për shmangien e
15 përgjegjësisë.

16 Për sa i përket kalendarit procedural, unë do të
17 dëshiroja disa parashtime gojore. Mund të japim pushim por
18 paraqes, por shpresoj që mocionet tuaj t'i marr gjatë ditës së
19 sotme.

20 Z. GILISSEN: [Përkthim] Jo nuk fola për alibinë.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Kërkoj ndjesë e tërheq atë
22 që përmenda për procesverbalin. Për çështjen e mundësinë unike
23 hetimore si dhe arsyet për mungesën e përgjegjësisë.

24 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë të bëjmë një pushim

1 30 minutësh dhe t'ju jap mundësinë që të paraqisni komentet që
2 kanë të bëjnë me kalendarin procedural.

3 Është ora 10.35, sipas orës së Hagës dhe do të marrim një
4 pushim. Dhe e filloj seancën sërish në orën 11.05.

5 Seanca mbyllet.

6 --- Pauza fillon në orën 10.35

7 --- Seanca rifillon në orën 11.05

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Gilissen, cilat janë
9 parashtrimet tuaja lidhur me kalendarin procedural?

10 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës.

11 Faleminderit, i nderuar Gjykatës. Jam paksa i çuditur në
12 lidhje me trysninë që po ushtrohet mbi ne.

13 Dosja kundër z. Shala ka filluar para disa viteve. Gjatë
14 të gjithë këtyre viteve ZPS-ja ka patur mundësinë që ta
15 përgatisë çështjen e saj. Kjo është normale, dakord. Ne jemi -
16 - merremi tani me këtë çështje prej më shumë se një viti, një
17 viti e gjysmë dhe jam i çuditur dhe i zhgënjyer që ju mendoni
18 që ne nuk po punojmë sa duhet apo me ritmet e duhura.

19 Kjo nuk është e vërtetë. Ne përballemi me një numër
20 vështirësish. Së pari, lidhur me nxjerrjen e materialeve nga
21 ana e ZPS-së dhe ju e dini shumë mirë që -- dhe ato kanë pasur
22 vështirësi dhe nuk e kanë përfunduar nxjerrjen e tërë
23 materialeve. Për më tepër, Prokurori kërkon që të shtojë
24 dëshmitarë të rinj dhe më duket që kur ju tërë trysninë po e
25 ushtroni mbi palën tonë.

1 Ta fillomë me hetimin. Ju e dini se sa e vështirë është
2 organizimi në terren i ekipeve që merren me çështjen e
3 hetimeve. Ne i kemi filluar këtë hetime ne ishim në Kosovë
4 para dy javëve më duket. Ishte një vizitë e frytshme dhe
5 gjetëm një numër çështjesh shumë të çuditshme ndoshta jo të
6 çuditshme po sikur lexoheshin informacionet e siguruara nga
7 ZPS-ja, krijuam një ndjesi jo të mirë kundër disa dëshmitarëve
8 apo elementëve. Edhe me elemente material.

9 Në terren ne takuam një numër njerëzish një numër
10 njerëzish - ishim te kjo fabrika e famshme e Kukësit dhe
11 zbuluam një numër gjërash shumë interesante dhe prandaj
12 dëshirojmë që t'i vazhdojmë hetimet edhe gjatë kohës së
13 gjyqit. Tani për shkak të nevojës për të marrë disa qëndrime
14 shumë delikate ne jemi në gjendje të themi që, siç u thamë që,
15 do i përmbushim përgjegjësinë tona dhe nuk mund të shtrohet
16 çështja siç e shturat ju.

17 Kam më se 20 vite që nga koha e fakteve të pretenduara
18 dhe kjo krijon vështirësi. E dini shumë mirë që disa njerëz
19 ndërruar jetë, disa nga dëshmitarët e akuzës kanë vdekur. E
20 njëjta gjë vlen edhe për palën Mbrojtëse.

21 Ne kur vizitojmë Organizatën e Veteranëve të Luftës,
22 qeverinë, pjesëtarëve të UÇK-së pasi jemi të detyruar të
23 bisedojmë me ta dhe ata nuk janë në gjendje që të na sigurojnë
24 dokumentacione të cilat kanë ekzistuar dikur por nuk
25 ekzistojnë më për shkak të kohës të gjatë që ka kaluar. Dhe ju

1 mendoni që ne brenda një viti të mund të hartojmë dosjen tonë
2 paraprake. Ne sapo e kemi marrë dosjen paraprake të ZPS-së,
3 vetëm para disa ditëve.

4 Dhe kur lexoj këtë dosje paraprake kam zbuluar një duzinë
5 emrash të njerëzve që nuk i kishim dëgjuar më parë. Ne na
6 duhet që të kontrollojmë verifikojmë hetojmë lidhur me këtë.
7 Është problem i disiplinës në këtë çështje. Nuk kemi gjë për
8 të fshehur këtu.

9 Megjithatë ne përballohemi me një problem shumë të madh
10 për shembull që ka të bëjë me trupin e vëllait të një
11 dëshmitari të rëndësishëm. Ne vendosëm kontakte me disa
12 ekspertë të fushës mjeko-ligjore, jo miq të mi apo të z.
13 Aouini, por ekspertë ndërkombëtarë të mirënjohur dhe po presim
14 rezultatet. Dhe do të varet nga -- Mbrojtja e z. Shala varet
15 nga rezultatet e këtij eksperti mjeko-ligjor.

16 Ne po hetojmë disa çështje shumë çuditëse. Dëshmitarë të
17 rëndësishëm në kohën e z. Shala e kanë i kanë ndryshuar shpesh
18 herë deklaratat e tyre. Dhe jemi të çuditur se si hetuesit nuk
19 i kanë pyetur se përse, përse i keni ndryshuar deklaratat kaq
20 shpesh. Ne na duhet që të bëjmë verifikimin e ndryshimit midis
21 këtyre varianteve të ndryshuara jetën e dëshmitare dhe
22 njerëzve të tjerë të cilët janë pjesë e dosjes paraprake të z.
23 Prokuror. Dhe kur kemi parë këtë kemi zbuluar një numër
24 gjërash të reja. Gjërat kanë ndryshuar për këtë dëshmitar dhe
25 po kështu edhe deklaratat e tij.

1 Është një problem shumë i madh. Pra të marrin tani një
2 qëndrim lidhur me provueshmërinë apo për një gjë kaq të
3 rëndësishme sa dosja paraprake në momentin kur Prokuroria ende
4 nuk na i ka dorëzuar informacionet që ka në dispozicion. Dhe
5 unë mendoj që ky është një qëndrim jorealit. Kur të na jepet
6 i gjithë ky dokumentacion këto deklaratë, këto elemente, që
7 Prokuroria me të drejtë do t'i përdorë gjatë gjyqit, dakord.
8 Problemi nuk është që ne duhet thjesht të na i japin, ne duhet
9 të kemi kohën për t'i lexuar, për t'i analizuar. Dhe mund të
10 them që punojmë me ritme mjaft të larta. Kjo nuk është çështje
11 se sa shumë volum pune bën, por sa mirë e bën punën.

12 Dhe unë mund të them siç e thashë dhe më herët që çështja
13 kundër z. Shala mund t'i duket ndokujt që nuk është aq e
14 rëndësishme krahasuar me çështjet e tjera. Ndoshta mund t'i
15 duket shumë e vogël por nuk është e atillë. Është gabim të
16 imagjinohet që ne do të mund ta realizojmë punën tonë pa u
17 përballuar me vështirësitë me të cilat janë përballuar palët
18 mbrojtëse dhe gjykatësit në rastet e tjera penale.

19 Unë mendoj që ne punojmë, punojmë me ritme mjaft të larta
20 dhe sigurojmë disa rezultate dhe kjo nuk është çështja që duam
21 të fitojmë kohë. Nuk është fare kjo çështje. Nuk kemi nevojë
22 për këtë. Kur Prokurori t'i ketë nxjerrë të gjitha dokumentet
23 dhe tani po i drejtohem atij, nuk ka nevojë për shumë kohë.
24 Jemi në fund të procesit sipas mendimit tim.

25 Dua të kemi mundësinë për më tepër të sigurojmë

1 rezultatin e ekspertizës mjeko-ligjore, mundësinë për të
2 hedhur hapat e fundit hetues, atëherë mund të imagjinohet se
3 kjo nuk është çështje muajsh. Duhet ta kuptojnë të gjithë që
4 dokumentet duhen lexuar dhe rilexuar.

5 Ky është një problem i madh me të cilin përballohem në
6 fazën e nxjerrjes së dokumenteve. Kur ne marrim dokumente të
7 reja, kjo nuk është një vështirësi aq e madhe megjithëkëtë,
8 kur lexon dhe vëren që ka ndryshime me atë që ka ndodhur dy a
9 tre muaj më parë, neni - jemi të detyruar që të lexoni, të
10 rilexoni, nuk di nëse ekziston fjala në anglisht, lexon, por
11 duhet bërë leximi duke vendosur edhe ndërlidhjen.

12 Dhe kjo është çështje delikate. Ne si palë mbrojtëse nuk
13 krijomë ndonjë variant që të thotë që ka patur një skandal të
14 madh e kështu me radhë, por jemi përballë një situatë delikate
15 e cila kërkon që t'i kuptojmë të gjitha elementet dhe jam i
16 sigurt që jeni i ndërgjegjshëm. Bëhet fjalë për krime lufte.
17 Nuk bëhet fjalë për shitje droge në rrugë dhe përballemi me
18 vështirësi të mëdha kur e dimë që z. Shala nuk ka qenë në
19 Kosovë për shumë kohë. Duam të dimë si ka qenë situata e z.
20 Shala kur ka qenë në Kosovë në vitin 1999. E vështirë, shumë e
21 vështirë.

22 Unë nuk po përmend këtu njerëzit që kemi takuar por për
23 dëshmitarët e Prokurorisë. Ata të gjithë bëjnë deklaratatë të
24 ndryshme në mënyra të ndryshme.

25 Kjo nuk është çështje e punës tonë, është çështje e

1 profesionalizimit. Do të ishte gabim që të kalonim në gjyq në
2 këtë moment kohore. Kemi nevojë për më shumë kohë. Dhe kjo
3 është realiste. Realiste do të ishte që të vazhdonim të
4 punonim gjatë majit, qershorit, korrikut dhe gushtit.

5 Dhe nuk e kam asnjë synim që të kërkoj për shtyrje të
6 këtij afati. Varet nga materialet që do të marrim nga ZPS-ja,
7 por më lejoni se siç e kam thënë edhe më parë jemi në fund të
8 këtij procesi. Nëse nuk bëj ndonjë gabim dhe të urreja nëse do
9 të bëja gabim pasi ju do ta përsërisnit gabimin tim, do të
10 thoja që do të arrijmë që dokumentin që kundërshton
11 provueshmërinë e provave ta dorëzojmë nga fillimi i shtatorit,
12 që është fundi i pushimit të gjykatës për të gjithë ne. Ne
13 jemi të detyruar që të punojmë gjatë kësaj periudhe. Dhe nga
14 ana ime mund të them që nuk do të bëj pushime.

15 Më duket që nga mesi i shtatorit do të jemi në gjendje që
16 ta dorëzojmë dosjen paraprake.

17 Unë mendoj që kjo është e arsyeshme. Nuk di nëse më duhet
18 të shtoj ndonjë gjë tjetër. Jam përpjekur që të jem sa më i
19 saktë dhe kjo nuk është gjithnjë e lehtë për anglishten time
20 të dobët.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, është shumë e
22 saktë. Faleminderit pra për këtë parashtrim shumë të
23 hollësishëm.

24 Z. Prokuror lidhur me kalendarin procedural çfarë keni
25 për të thënë?

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Vetën disa komente, përpara se
2 të paraqesim një qëndrimin tonë lidhur me ndryshimin e afateve
3 që kërkon pala mbrojtëse.

4 Ne shumicën e dokumenteve të çështjes sonë i kemi nxjerrë
5 përpara përfundimit të verës 2021, çështja jonë nuk ka
6 ndryshuar. Disa hetime për shembull si për shembull një vizitë
7 në këtë fabrikën e metalit mund të ishin bërë shumë përpara.
8 Ndryshimi apo ndryshimet e pretenduara të deklaratave të
9 dëshmitarëve janë -- kanë qenë të njohur për palën Mbrojtëse
10 prej një kohe të mjaft të gjatë.

11 Hetimet shtesë që ZPS-ja është detyruar të bëjë kohet e
12 fundit dhe siç e kemi shpjeguar në parashtrimet tona me shkrim
13 kanë ndodhur për shkak të ngjarjeve të paparashikuara mund të
14 shtoj këtu zyrtarisht se nuk i ndryshojnë faktet, çështjen
15 tonë, nuk shtojnë fakte të reja, nuk ka ndryshuar. Nuk ka
16 ndryshuar çështja e ZPS-së dhe po të na lejoni, i nderuar
17 Gjykatës, ne do t'i nxjerrim edhe këto materiale apo deklarata
18 shtesë.

19 Për sa i përket njoftimit të rregull 102(3) nuk është kjo
20 çështje e diskutueshme, pasi ne i përmbushim detyrimet tona në
21 këtë kontekst.

22 Ndërsa çështjes së kundërshtueshmërinë së pranueshmërinë
23 ne i kuptojmë nevojën që Mbrojtja t'i analizojë të gjitha
24 provat që ne duhet të paraqesim në çështjen tonë por kjo mund
25 të bëhet edhe gjatë gjyqit, nderuar Gjykatës. Ka procedura për

1 të kundërshtuar materialet dhe kjo bëhet në formë të shkruar
2 apo për të kundërshtuar pranueshmërinë e dokumenteve të cilat
3 ZPS-ja mund t'i paraqesë gjatë gjyqit

4 Këtë ne nuk e shohim si një vështirë që duhet të
5 ngadalësojë ecjen e procedurave më tej.

6 Megjithëkëtë, i nderuar Gjykatës, kur z. Gilissen
7 përshkruan vështirësitë me të cilët po ballafaqohen janë këto
8 vështirësitë me të cilat përballohen të gjithë ata që
9 përgatisin një gjyq për ngjarje të ndodhura pra 23 viteve. Kjo
10 është një punë që bëhet në të gjitha çështjet, në çështjet e
11 krimeve të luftës dhe na përket të gjithëve neve.

12 Me qëllim që procesverbali të jetë i qartë, i nderuar
13 Gjykatës, unë dua të them që ne nuk e kundërshtojmë një
14 shtyrje të arsyeshme të afateve që kërkon Mbrojtja, me qëllim
15 që ta përgatisë çështjen e saj në mënyrën e duhur.

16 Donim thjesht të sqaronim disa hapa si për shembull që
17 pranueshmëria e provave nuk duhet të përfundohet në këtë fazë.
18 Dhe pavarësisht faktit që disa material janë nxjerrë vetëm
19 muajve të fundit shumica e dokumenteve që i përkasin kësaj
20 çështje janë nxjerrë para shumë muajve dhe kjo nuk ka
21 ndryshuar dhe nuk do të ndryshojë, në qoftë se ju, i nderuar
22 Gjykatës, do ta lejoni Prokurorinë që të nxjerrë edhe
23 materiale që ne po kërkojmë tani t'i nxjerrim në bazë të
24 rregullës 102(2).

25 Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

2 Para se t'ja jap fjalën Mbrojtjes, a mund të më kujtoni datën
3 e dosjes tuaj paraprake?

4 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Unë besoj që është dorëzuar me
5 28 janar 2022, por më duhet ta verifikoj.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

7 Z. Aouini.

8 Z. AOUBINI: [Përkthim] Faleminderit, por ajo është data që
9 ju është dorëzuar dosja juve por jo neve.

10 Një çështje specifike për sa i përket dosjes paraprake, i
11 nderuar Gjykatës dhe asaj që kërkohet të shfrytëzohet gjatë
12 gjyqit.

13 Dosja paraprake ka një duzinë emrash dhe hollësisë në to.
14 I përmendën më seancën paraprake. Ka njerëz të cilët nuk janë
15 dëshmitarë të listë apo viktime për të cilat nuk ka prova për
16 të cilat duhet hetuar. Nuk duhet ta kufizojmë veten në numrin
17 e dëshmitarëve të paraqitur nga ZPS-ja, për shkak se disa nga
18 emrat e individëve dhe hollësitë e tyre janë hetuar nga ZPS-
19 ja. Dhe prandaj është e rëndësishme që të bëhet ndërlikohje
20 midis dëshmive të dhëna nga këta emra, nga këto individë. Dhe
21 kjo është pjesë e hetimeve dhe e analizës sonë me qëllim që të
22 mbajmë qëndrimet tona. Këtu nuk është çështje se kë do të
23 paraqesë si dëshmitar ZPS-ja, është problemi i analizës dhe i
24 hetimeve nga ana jonë.

25 Duhet të analizojmë për shembull faktin përse një person

1 është përmendur në dosja paraprake por nuk është intervistuar
2 apo nuk do të vijë si dëshmitar dhe prandaj siç e tha z.
3 Gilissen kjo është pjesë e një pune voluminoze që ne duhet ta
4 bëjmë dhe duhet ta bëjmë në mënyrën më të ndërgjegjshme. Kjo -
5 ajo e cila sipas ZPS-së është shumica apo thelbi i çështjes
6 nuk është thelbi i çështje për ne.

7 Z. Gilissen.

8 Z. GILISSEN: [Përkthim] Edhe një gjë tjetër.

9 Sa për të dhënë një shembull. Shpresoj që ta kuptoni. Ne
10 kërkuam nga ZPS-ja disa dokumente të cilat ishin në listë,
11 dokumente të cilët ZPS-ja nuk dëshiron t'i shfrytëzojë gjatë
12 gjyqit dhe janë dokumente shumë të çuditshme për ne. Siç e tha
13 z. Aouini për shkak se është dokument për shembull në
14 serbisht. Mund ta them që serbishtja është shumë e dobët,
15 anglishtja është dakord e përdorshme por serbishtja jo.

16 Nuk kemi përkthyes në serbishte. Dhe kjo është një
17 problem, ne i kërkuam z. Shala që ta lexojë këtë dokument pasi
18 është në gjendje të lexojë në serbisht dhe ai na shpjegoi një
19 numër gjërash. Gjëra interesante, por të habitshme që kishin
20 të bënin me disa shpikje, falsifikime, gjëra të kësaj natyre,
21 pra. Dëshmitarë të cilët flisnin për disa falsifikime të kësaj
22 natyre.

23 Ne kërkojmë -- e vlerësojmë atë që ka bërë z. Shala por
24 ne na duhet një përkthyes për këtë dokument dhe kjo kërkon
25 kohë, siç ju thashë më herët unë fola mbi lajmin e ditës së

1 djeshme dhe kjo është vështirësi për sa i përket palës
2 Mbrojtëse.

3 Ne siç ju thashë edhe një herë, ne duhet të mos bëjmë
4 gabime. Nuk dua që unë apo ekipi im të bëjnë gjëra idioteske.
5 Por shpresoj që të mund ta vazhdojmë punën tonë në këtë
6 drejtim, z. Kryetar.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Gilissen.
8 Prokurori.

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Edhe një herë po them që ne nuk
10 e kundërshtojnë një shtyrje të afatit, por emrat e dosjes
11 paraprake nuk kanë ardhur nga asgjëja. Ato ishin pjesë e
12 materialeve të cilat janë nxjerrë përpara dorëzimit të dosjes
13 paraprake.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Më korrigjoni nëse e kam
15 gabim por versioni i redaktuar konfidencial i dosjes paraprake
16 i është dorëzuar Mbrojtjes më datën 21 janar apo jo?

17 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Korrekt.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Laws, më duhet të them
19 për procesverbal që ka një problem me lidhjen me audio dhe nuk
20 është me zërin që vjen për ju për ta dëgjuar, por zëri juaj po
21 të doni të flisnit është problem. Për këtë konferencë për
22 ecurinë e çështjesh a doni të bëni ndonjë parashtrim mbi këtë
23 çështje? Do t'ju kërkoja që të përpiqeni të më dërgoni me
24 postë -- fatkeqësisht unë nuk ju dëgjoj.

25 A e kuptoj që ju nuk dëshironi të bëni ndonjë parashtrim

1 mbi këtë çështje?

2 Dakord. E mbajmë shënim dhe faleminderit z. Law.

3 I kthehem edhe një herë palëve.

4 Atëherë, të kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës që
5 janë pikat e dakordësimit mbi çështjet juridike dhe faktike.

6 Me 8 prill ZPS-ja bëri një parashtrim në lidhje me pikat
7 faktike dhe ligjore për të cilat palët janë pajtuar.

8 Kam parasysh këtë parashtrim dhe numrin të kufizuar të
9 pikave për të cilat palët pajtohen. Më kujtohet që në
10 konferencën për ecurinë e çështjes të datës 4 mars i urdhërova
11 palët që të bëjnë, finalizojnë diskutimet e tyre *inter partes*
12 dhe të parashtrojnë pikat për të cilat pajtohen në lidhje me
13 çështjet faktike dhe ligjore jo më vonë se 8 prill i këtij
14 viti.

15 Në qoftë se palët nuk kanë ndonjë kërkesë tjetër për
16 ndryshimin e afatit kohor atëherë do ta konsideroj
17 parashtrimin të ZPS-së të 8 prillit për dokumentin e
18 dorëzimit.

19 A keni diçka për të shtuar z. Prokuror

20 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo nuk kam.

21 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit.

22 z. Aouini.

23 Z. AOUBINI: [Përkthim] Po, një çështje z. Kryetar, kemi

24 një pajtim po për të cilën domethënë duhet ta vendosim në

25 procesverbal. Kemi kërkuar në fazat e mëhershme të kësaj faza

1 paraprake presionet audio dhe video të disa intervistave me
2 dëshmitarët. E kemi të qartë ZPS-ja po punon shumë që ta
3 mundësojë këtë nga aspekti teknik po thjesht e ngritëm këtë
4 pikë për ta pasur të regjistruar në procesverbal.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Aouini.

6 Prokuror a keni diçka për të thënë në lidhje me këto
7 material videovizuale?

8 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës, një
9 prej arsyeve se pse Mbrojtjes i duhej akses në këto video
10 ishte që një pjesë e transkripteve ishin vende-vende të
11 pakuptueshme ose nuk dëgjoheshin mirë dhe ky problem duhej të
12 zgjidhje.

13 Dhe prandaj, tani Mbrojtja kërkon qasje në këto video.

14 Ne kishim pengesa në nxjerrjen e këtyre videomaterialeve
15 ku -- për ato pjesët që ishin të redaktuara që e bënë mjaft të
16 vështirë procesin e shkëputjes së një pjesë të videos.

17 Tani ju, i nderuar Gjykatës e dini që kemi nxjerrë
18 versione me më pak redaktime të disa deklaratave, këtë e kemi
19 bërë në lidhje me dy dëshmitarë, 4734, do ta bëjmë të njëjtën
20 edhe për disa dëshmitarë të tjerë për të cilët Mbrojtja ka
21 kërkuar t'i jepet qasje në videoincizimin e deklaratave apo
22 intervistave të tyre. Ne nuk i kemi harruar këtë. Ne e
23 konsiderojmë që e kemi zgjidhur një pjesë të këtij problemi
24 duke dhënë transkriptet e rishikuara të këtyre intervistave
25 Mbrojtjes. Ne do të punojmë edhe më tej që ta përmbushim

1 plotësisht kërkesën e Mbrojtjes.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Prokuror.

3 A keni diçka për të shtuar z. Aouini.

4 Z. AOUBINI: [Përkthim] Jo. Pjesa e dytë e kërkesës time u
5 përmend nga kolegu. Pra disa elemente, domethënë, të këtyre
6 intervistave nuk duhet vetëm të lexohen por duhen edhe të
7 vizualizohen të shihen.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Aouini.

9 Tani do t'ju kërkoj palëve të më tregojmë nëse kanë edhe
10 diçka tjetër për të ngritur në këtë konferencë.

11 Prokuror.

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit Prokuror.

14 z. Gilissen.

15 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit z. Gjykatës s'kemi
16 asgjë për të ngritur.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit z. Gilissen.

18 Në qoftë se ka nevojë që të mbajmë edhe një konferencë
19 për ecurinë e çështjes përpara pushimit veror të gjykatës, unë
20 i kam identifikuar datat 30 maj të këtij viti si datë e
21 mundshme kur salla e gjyqit është në dispozicion. Mirëpo
22 Mbrojtja ka bërë të ditur që nuk është e disponueshme në atë
23 datë. Do të bëj hetime të mëtejshme në lidhje me
24 disponueshmërinë e sallës së gjyqit në mënyrë që të
25 organizojmë konferencën e ardhme në datë të favorshme për të

1 dy palët.

2 Tani do të bëjmë një pushim prej gjysmë ore dhe pastaj do
3 të bëj disa urdhra gojorë në lidhje me kalendarin procedural.

4 z. Aouini a keni diçka për të thënë?

5 Z. AOUINI: [Përkthim] Vetëm një përkujtim në lidhje me
6 kërkesën tonë për modifikimin e afatit.

7 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Nuk e kam harruar z.
8 Aouini. Unë do ta bëj këtë urdhër gojarisht bashkë me urdhrat
9 e tjerë dhe do t'i nxjerr këto urdhra gojarisht pas pushimit
10 të dytë.

11 Vazhdojmë pas gjysëm ore.

12 --- Pauza fillon në orën 11.36

13 --- Seanca rifillon në orën 12.06

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Znj. Sekretare a mund të
15 konfirmoni që jemi në seancë publike?

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës,
17 jemi në seancë publike.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit znj.

19 Sekretare.

20 Përpara se të përfundojmë këtë seancë do të lëshoj dy
21 urdhra gojorë lidhur me materialet e rregullës 102(3) dhe mbi
22 kalendarin procedural për pjesën që ka mbetur të fazës
23 paragjyqësore. Përpara se ta bëj këtë vërej kërkesën e
24 Mbrojtjes për ta shtyrë afatin për të paraqitur versionet e
25 redaktuara publike të parashtrimeve që kanë të bëjnë me

1 rishikimin e paraburgimit të z. Shala.

2 Dhe për sa i përket afate që janë të ndryshme e ndryshoj
3 urdhrin e parë gojor që kam lëshuar gjatë konferencës së sotme
4 për ecurinë e çështjes.

5 Për sa i përket paraqitjes së mocioneve të lartpërmendura
6 dhe për rrjedhojë e urdhëroj Zyrën Administrative, Mbrojtjen
7 dhe ZPS-në sipas rastit, që të dorëzojnë variantet publike të
8 redaktuara të këtyre dosjeve që kanë të bëjnë me paraburgimin
9 e z. Shala dhe jo vonë se 22 prill 2022 dhe janë materialet
10 F00152, F100171, F00177 dhe F00184.

11 Pasi kam dëgjuar palët tani do të nxjerr urdhrin e dytë
12 gojor.

13 Unë mendoj që ZPS-ja e ka demonstruar arsye të
14 qëndrueshme për ta amenduar njoftimin e saj sipas rregullës
15 102(3) të Rregullores mbi bazën e dorëzimit të materialit
16 F00170 dhe kërkesës gojore që ka bërë në konferencën e sotme
17 mbi ecurinë e çështjes.

18 Së pari për sa i përket materialit F00170 vërej se
19 dokumente të kësaj të kategorisë së parë i janë nënshkruar
20 kufizime të rregullës 107 të Rregullores dhe ato të cilat
21 tashmë kanë rënë. Ndërkohë që dokumentet e kategorisë së tretë
22 vijnë nga kërkesa që ka bërë mbrojtja.

23 Për më tepër pavarësisht që dokumentet e kategorisë së
24 dytë janë të vitit 2010, vërej që numri i këtyre dokumenteve
25 është i kufizuar dhe ato janë -- përbëjnë kontekst për

1 materiale provë nga një çështje tjetër e cila është pjesë e
2 njoftimit të ZPS-së sipas rregullit 102 dhe si përfundim mund
3 të thuhet se Mbrojtja nuk e kundërshton këtë amendim.

4 Si përfundim e miratoj kërkesën e ZPS-së për ta ndryshuar
5 njoftimin sipas rregullës 102(3) të Rregullores duke përfshirë
6 dokumente të specifikuara në poshtëshënimet 9-14 për sa i
7 përket materialit F00170.

8 Së dyti, për sa i përket kërkesës gojore së ZPS-së për ta
9 amenduar njoftimin e saj sipas rregullës 102(3) të Rregullores
10 duke përfshirë dokumentin ERN SITF14574 deri në 0014576, vërej
11 se zbatoj se kërkimi ka të bëjë me një dokument i cili është
12 gjetur gjatë rishikimit të çështjes dhe Mbrojtja nuk e
13 kundërshton këtë amendament dhe për këtë e miratoj kërkesën e
14 ZPS-së për ta amenduar njoftimin sipas rregullës 102(3) të
15 Rregullores duke përfshirë dokumentin e lartpërmendur.

16 Këtu përfundon urdhri im i dytë gojor.

17 Vërej po kështu kërkesat e ZPS-së për të -- për sa i
18 përket kërkimit të lejes për dokumentet shitesë të rregullit
19 102(3) që kanë të bëjnë me materialet që i ka patur më parë
20 ZPS-ja dhe të cilat po nxirren vetëm në këtë fushë apo faktit
21 nëse ky udhëzim është një udhëzues i vazhdueshëm i cili
22 përfshin të gjitha materialet të cilat mund t'i marrë ZPS-ja
23 në të ardhëm, të cilat janë pjesë e kërkesave të kësaj
24 çështjeje dhe konfirmoj që udhëzimet e mia përfshijnë të
25 gjitha amendimet e njoftimit të rregullës 102(3) pavarësisht

1 nëse është rezultat i materialeve në posedim të ZPS-së apo
2 materiale të cilat janë siguruar së fundmi -- materiale të të
3 reja të siguruara nga ZPS-ja.

4 Së fundi do të nxjerr urdhrin e tretë për ndryshimin
5 kalendarit procedural të paraqitur në konferencën për ecurinë
6 e çështje të 4 mars 2022, duke pasur parasysh parashtrimet e
7 bëra nga palët në takimin e sotëm.

8 Së pari, duke mbajtur parasysh kam autorizuar ndryshimin
9 e njoftimit sipas rregullës 102(3) të Rregullores nga ana e
10 ZPS-së e urdhëroj palën Mbrojtëse që të dorëzojë -- të kërkojë
11 që materialet e përfshira në këtë njoftim t'i kërkojnë jo më
12 vonë se 29 prill 2022.

13 E dyta, ZPS-ja do të paraqesë të gjitha kërkesat që
14 mbeten për sa i përket masave të nxjerrjes, kryesisht për sa i
15 përket masave mbrojtëse, jo më vonë se 6 maj 2020 [sipas
16 përkthimit] përfshirë çështjen që është përmendur nga ZPS-ja
17 në seancë private.

18 E treta, duke mbajtur parasysh kërkesën e ZPS-së për
19 shtyrje të afatit, ZPS-ja me përjashtim të materialeve të
20 cilat kërkojnë masa mbrojtëse apo autorizim juridik, duhet t'i
21 përfundojë të gjitha detyrimet e saja paragjyqësore jo më vonë
22 27 maj 2022 dhe do të të paraqesë një njoftim të çështjes
23 aktuale duke dhënë një pamje të përgjithshme të hollësishme të
24 të gjitha materialeve të nxjerra në të njëjtën kohë.

25 Pala Mbrojtëse në bazë të rregullës 95(2)(e) të

1 Rregullores do t'i paraqesë të gjitha kundërshtimet ndaj
2 materialeve provë të cilat nuk janë nxjerrë në bazë të
3 rregullit 102 të Rregullores jo më vonë se 22 korrik 2022.

4 Në këtë kontekst vërej që ZPS-ja i ka përfunduar
5 pothuajse të gjitha nxjerrjet e materiale në bazë të rregullës
6 102(1) (b) dhe 103 dhe 107 të Rregullores, ndërkohë që ka
7 nxjerrë edhe një numër shumë të madh të materialeve sipas
8 rregullës 102(3).

9 Përveç kësaj Mbrojtja ka treguar se do ta fillojë
10 vlerësimin e këtij materiali që ka në posedimin e saj. Dhe së
11 fundmi kjo është për të mos dëmtuar të drejtën e palës
12 Mbrojtëse për të kundërshtuar materiale gjatë gjyqit.

13 E katërta, pala Mbrojtëse do të paraqesë hollësi
14 specifike për njoftimin e saj, pra alibinë jo më vonë se 1
15 korrik 2022.

16 E pesta, pala Mbrojtëse do të paraqesë dosjen paraprake
17 nëse do ta bëjë këtë jo më vonë se 15 gusht 2022. Në këtë
18 kontekst unë vërej që pala mbrojtëse i është refuzuar volumit
19 të materialit të nxjerra për të argumentuar që nuk do të mund
20 ta dorëzojë dosjen e saj paraprake në periudhën më të hershme
21 në mes të shtatorit. Megjithëkëtë pala Mbrojtëse ka pasur në
22 posedim një numër të madh të materialeve të nxjerra, ka pasur
23 dosjen paraprake dhe tabelën e rregullës 109(c) për një kohë
24 të gjatë, pra, ka patur një kohë të madhe për ta bërë këtë.

25 Përveç kësaj, në bazë të rregullës 95(5) pala Mbrojtëse

1 duhet në qoftë se dëshiron të dorëzojë një dosje paraprake
2 duhet t'i tregojë palës - të tregojë në mënyrë të përgjithshme
3 se cilat akuzat dhe çështjet e kundërshtuara, listën e
4 dëshmitarëve, pa dëmtuar apo pa shkaktuar dëm për ndonjë
5 amendament të mëtejshëm.

6 Dhe së fundi, data e ardhshme për ta transmetuar këtë
7 çështje gjyqësore, tentative pra, është data 31 gusht 2022.

8 Këtu përfundon edhe urdhri im i tretë.

9 Falënderoj si gjithmonë të gjitha palët, Sekretarinë për
10 pjesëmarrjen e tyre, po kështu edhe përkthyesit, stenografët
11 dhe personelin e sigurisë.

12 --- Seanca mbyllet në orën 12.15

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25